



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE**

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE**

Nr.1311/7 Prot

Tiranë, më 11.10.2023

VENDIM

Nr.47, datë 11.10.2023

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, Qendra “Birn Albania”, përfaqësuar nga z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 1311 Prot., datë 02.08.2023, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik/Ministria e Financave dhe Ekonomisë (në vijim, “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, nëpërmjet kërkesës datë 06.07.2023, depozituar në adresën elektronike _____ referuar zbatimit nga ana e Autoritetit Publik, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 589, datë 07.09.2022 “Për rregullat dhe procedurat për konfiskimin për interes publik të objekteve të ndërtuara pa leje, për qëllim fitimi”, ka kërkuar t’i vendoset në dispozicion dokumentacioni në lidhje me:

1. Raporti i vlerësimit të vlerës për objektet e konfiskuara nga Këshilli Kombëtar i Territorit bazuar në VKM nr. 589 (Çmimi i përcaktuar i sipërfaqes së konfiskuar sipas objekteve).
2. Kontratat apo drafikontratat “Për kalim të drejtash dhe detyrimesh” midis Ministrisë dhe kompanive që kanë ushtruar apo shprehur vullnetin për të drejtën e parablerjes.

3. Kontratat dhe marrëveshjet me kompanitë si më poshtë: 1. “Xheluks Konstruksion” sh.p.k dhe “Devis Konstruksion” sh.p.k; 2. “Xheluks Kontruksion” sh.p.k dhe “Laxmi Real Estate & Investment” sh.p.k; 3. “Xheluks Konstruksion” sh.p.k dhe “Devis Konstruksion” sh.p.k; 4. “Xheluks Konstruksion” sh.p.k dhe “City Construction INC” sh.a.; 5. “FABRI_D” sh.p.k (ish zhvillues “ERE Architecture & Construction” sh.p.k; 6. “ARB & TRANS-2010” sh.p.k; 7. “Salilari” sh.p.k.
4. Raporte të vlerësimit dhe çmimi i përlllogaritur për sipërfaqet pa leje që parablejnë këto kompani.
5. Sipërfaqen totale të ndërtimit për të cilën MFE ka aplikuar për e-leje dhe certifikata përdorimi.

Autoriteti Publik, me e-mail-in datë 02.08.2023, ka kthyer përgjigje duke cituar se: “...Janë 25 vendime KKT të miratura në mbledhjet e datës 19.10.2022, 9.11.2022, 14.12.2022 dhe 28.12.2022. Nga 25 vendime të administruara rezultojnë:

- 13 konfiskime mbi 10%
- 8 konfiskime nën 10 %
- 4 konfiskime tërësisht pa leje
- Kemi 9 kërkesa për parablerje të sipërfaqes pa leje të cilat janë vlerësuar me vlerë tregu të fazës së objektit të konfiksuar, e përcaktuar nga ekspertët.
- Totali i pagesës së kryer në buxhet për 10% të garancisë dhe 1 objekt i plotë, është 265,038,339 ALL.
- Bashkëlidhur një draf-model për kontratën e kalimit të të drejtave (por që akti përfundimtar hartohet nga noteri pasi bëhet pagesa e plotë e vlerës).
- Nuk ka ende një kontratë të nënshkruar për kalim të drejtash, sepse jemi në fazën ku subjektet janë brenda afatit ligjor për të derdhur në buxhet vlerën 90% të objektit të vlerësuar.
- Raportet e vlerësimit janë hartuar nga ekspertë të licencuar dhe janë akte individuale në funksion të detyrës së ngarkuar me Urdhër Ministri dhe nuk mund të jenë objekt publikimi.
- MFE ka aplikuar për leje ndërtimi dhe certifikata përdorimi për rreth 26.000 m2 ndërtim.”

Pas përgjigjes së sipërcituar, me emailin e regjistruar pranë Komisionerit me nr.1311/1Prot., datë 02.08.2023, ankuesi ka saktësuar objektin e ankimit duke pretenduar se nuk i është vënë në dispozicion dokumentacioni i kërkuar në pikat 1 dhe 4 të kërkesës për informacion. Ndodhur në këto kushte, ankuesi i është drejtuar Komisionerit, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e dhënies së dokumentacionit nga autoriteti publik.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur”*, Komisioneri, me shkresën nr. 1311/1 prot., datë 03.08.2023 ka kërkuar nga Autoriteti Publik qëndrimin në lidhje me pretendimin e ngritur nga ankuesi, si dhe sqarime për zotërimin e informacionit/dokumentacionit të kërkuar, duke rivlerësuar në këtë mënyrë kërkesën për informacion, brenda datës 10.08.2023.

Koordinatori për të drejtën e informimit pranë Autoriteti Publik, me emailin e datës 23.08.2023 ka kthyer përgjigje duke sqaruar se, *për shkak të mungesës së personelit pasi janë në periudhën e kryerjes së lejeve të zakonshme, kërkojmë kohë për trajtimin e ankesës.*

Në vijim të përgjigjes së sipërcituar, me emailin e regjistruar pranë Komisionerit me nr.1311/3 Prot., datë 14.09.2023, ankuesi ka vijuar me ankimin duke rikujtuar se ende nuk ka përgjigje nga Autoriteti Publik.

Me qëllim verifikimin e fakteve dhe rrethanave, që mund të jenë bërë pengesë për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar, me Urdhrin nr. 148, datë 18.09.2023, Komisioneri vendosi fillimin e hetimit administrativ pranë Autoritetit Publik duke filluar nga data 20.09.2023. Pranë Autoritetit Publik u depozitua urdhri i inspektimit administrativ, i cili u protokollua me nr. 16607 Prot., datë 19.09.2023. Gjatë inspektimit, u kontaktua me Sekretaren e Përgjithshme pranë Autoritetit Publik, e cila kërkoi kohë deri me datë 03.10.2023 për të rivlerësuar qëndrimin e Autoritetit Publik në lidhje me pikën 1 dhe 4 të kërkesës për informacion.

Në tejkallim të afatit të kërkuar nga Autoriteti Publik, me emailin e regjistruar pranë Komisionerit me nr. 1311/6 Prot., datë 06.10.2023, ankuesi ka vijuar ankimin duke cituar se nuk ka marrë ende përgjigje.

Për sa më sipër, pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri konstaton se Autoriteti Publik nuk ka kthyer përgjigje në lidhje me pikat 1 dhe 4 të kërkesës për informacion datë 06.07.2023, duke mos përmbushur në këtë mënyrë kërkesën për informacion për të cilën është depozituar edhe ankesa.

Gjithashtu, gjatë inspektimit nga ana e Autoritetit Publik nuk u ngrit asnjë pretendim se mosvënia në dispozicion e dokumentacionit të kërkuar kufizohet nga neni 17 i LDI. Ndërkohë, lidhur me pretendimin e shprehur në përgjigjen e kthyer ankuesit nëpërmjet e-mail-it datë 02.08.2023, se: *“Raportet e vlerësimit janë hartuar nga ekspertë të licencuar dhe janë akte individuale në funksion të detyrës së ngarkuar me Urdhër Ministri dhe nuk mund të jenë objekt publikimi”*, Komisioneri vlerëson se, argumenti i dhënë nga Autoriteti Publik nuk qëndron.

Konstatohet se, jemi në kuadër të një procedure administrative dhe për rrjedhojë kufizimet e pretenduara nga Autoriteti Publik në rastin konkret nuk gjejnë zbatim, pasi subjektet e licencuara janë porositur dhe financuar nga Autoriteti Publik në kuadër të përmbushjes së veprimtarisë institucionale të këtij të fundit, për rrjedhojë publikimi i dokumentit të kërkuar, objekt shqyrtimi, duhet të ishte bërë publik edhe në funksion të transparencës.

Në nenin 2, të LDI parashikohet se: *“Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisë të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj”*. Në kuptim të këtij parashikimi, Ministria e Financave dhe Ekonomisë është Autoriteti Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në nenin 1 përcakton se: *“1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. 2. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. 3. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.”*

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se dokumentacioni i kërkuar në pikën 1 dhe 4 të kërkesës për informacion datë 06.07.2023, përmbush në parim kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të LDI sipas të cilit, *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”*.

Në këtë kuptim, Autoriteti Publik duhet të vendosë në dispozicion të kërkuarit çdo informacion/dokument pavarësisht nëse ai është i prodhuar apo administrohet nga ky i fundit në formën e zotëruar, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të LDI, sipas të cilit *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”*.

Gjithashtu, kërkuar/ankuesi është gazetar, i cili synon informimin e opinionit publik mbi çështje lidhur me funksionimin e autoriteteve publike, duke i shërbyer në këtë mënyrë interesit të lartë publik. Ky qëndrim i Komisionerit, gjen mbështetje në jurisprudencën e GJEDNJ-së, e cila në çështjen *“Társaság a Szabadságjogokért kundër Hungarisë”*, vlerësoi se, pengesat e krijuara, të cilat vështirësojnë aksesin në informacion me interes publik, mund të dekurajojnë punonjësit e medias ose në fusha të ndërlidhura me të, të realizojnë punën e “mbikqyrësit shoqërorë”, duke zvogëluar mundësitë e tyre për të ofruar informata të sakta dhe të besueshme.

Si përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike dhe çdo subjekti tjetër jo shtetëror, që ushtron funksione publike.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të LDI, “Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së Qendrës “Birn Albania”, përfaqësuar nga _____, me nr. 1311 Prot., datë 02.08.2023, ndaj Autoritetit Publik “Ministria e Financave dhe Ekonomisë”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas pikës 1 dhe 4 të kërkesës për informacion datë 06.07.2023, konkretisht: (“1. Raporti i vlerësimit të vlerës për objektet e konfiskuara nga Këshilli Kombëtar i Territorit bazuar në VKM nr. 589 (Çmimi i përcaktuar i sipërfaqes së konfiskuar sipas objekteve). 4. Raporte të vlerësimit dhe çmimi i përlllogaritur për sipërfaqet pa leje që parablejnë këto kompani.”), duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, brenda datës 18.10.2023.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallë së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijëni, sipas nenit 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë. 11.10.2023.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi